



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.177/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Ymer Hoxha anëtar, me pjesëmarrjen e pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja e Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), dega në Prizren, për shkak të vendosjes së posterit në vend publik, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, ndërsa subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), dega në Prizren, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 350.00 euro (treqind e pesëdhjetë), të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 10.10.2017, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendon se aktivistët e tyre, kanë vërejtur se në rrugën “Saracet”, në Prizren, në shtyllen elektrike ishte vendosur poster i kandidates për asamble Sevilay Igci Hapici, për Komunen e Prizrenit, nga radhët subjekti politik KDTP. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik KDTP, ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014 të KQZ-së.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja.

Në përgjigje në ankesë të datës 12.10.2017, subjekti politik KDTP, thekson se pas pranimit të ankesës nr. ZL.Anr.81/2017 të dt.26.09.2017, kanë ndërrmar masat paraprake për heqjen e posterave, ashtu që para kësaj ankese me nr. Anr.177/2017 të datës 10.10.2017, nuk kanë pasur postera në vendet e përmendura në ankesë. Për të mbështetur pretendimet e tij, përgjigjes ia ka bashkangjitur një fotografi.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografia e ofruar si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se poster i kandidates për anëtare të Komunës së Prizrenit nga radhët e subjektit politik KDTP, është vendosur në shtyllë elektrike, gjegjësisht në objekt publik, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33

pika b) të LZP-së e cila përcakton: “Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave, njoftimeve dhe slloganeve, në objekte publike.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik KDTP, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se e njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre për shkeljen e supozuar, pretendimet në ankesë nga ana e panelit janë vlerësuar si pa ndikim në marrjen e vendimit më të favorshëm për subjektin në fjalë. Ndërsa, veprime që kanë ndërmarrë për të bërë përmirësimin e shkeljes nga Paneli janë vlerësuar pozitivisht dhe me ndikim në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi dënimi i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Zl.Anr. 177/2017 më datën 12.10.2017.

Kryesuesi i Panelit

Fejzullah Rexhepi



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.***